



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 28.1.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.40/2012”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012”, në mbledhjen e tij të datës 28 janar 2018.

Projektli “Siguria e digave” synon dhënien e kontributit për sigurinë e digave hidroenergjetike në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat, si dhe përmirësimin e efikasitetit të shfrytëzimit të këtyre digave hidroenergjetike e rritjen e qëndrueshmërisë së furnizimit të energjisë në tregun rajonal të energjisë elektrike.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it, për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, e cila është ratifikuar me ligjin nr. 40/2012. Letërmarrëveshja ndryshuese synon rishpërnarjen e fondeve për të financuar konsulencën teknike për supervizionin e punimeve shtesë të rehabilitimit elektromekanik dhe sistemit të kontroll-monitorimit të HEC-it të Komanit.

Teksti i propozuar përfaqëson komunikimin e Bankës Botërore, e cila njofton që, në mënyrë unilaterale, rishpërndan fondet nga kategoria 4 e projektit, në kategorinë 1 të projektit (skeduli 2, seksioni 4).

II. PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT

Kjo letërmarrëveshje parashikon ndryshimet si më poshtë:

- Shtesë financimi për punime shtesë të paparashikuara në kontratë, por që janë të domosdoshme për t’u kryer. Kjo është konstatuar pas demontimit të agregatëve 1, 2 dhe 3. Kostot e këtyre punimeve nuk ishin llogaritur në marrëveshjen e financimit të vitit 2012 pasi pa u demontuar agregatët nuk është e mundur të konstatohen dëmtimet dhe për rrjedhojë nuk mund të bëheshin

përlllogaritje të sakta. Duke qenë se plani i disbursimeve bazohet në këto përlllogaritje, ai duhet të rishikohet duke propozuar rishpërndarjen e fondeve dhe konkretisht fondet e lira në kategorinë 4 prej 461.250 eurosh kalojnë në kategorinë 1 “Mallra dhe punime”.

- Shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve deri në datë 31.12.2020, pasi përveç fondeve shtesë, këto punime kërkojnë edhe kohë shtesë për t’u kryer.

III. DISKUTIMET NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me mirëmbajtjen sistematike të digave në përgjithësi; eficientësinë e shfrytëzimit të burimeve hidrike të liqenit të Komanit pas ndërhyrjeve që po bëhen në kuadër të projektit “Siguria e digave”; ndikimin e këtyre punimeve në rritjen e qëndrueshmërisë së furnizimit të energjisë në tregun rajonal të energjisë elektrike; etj.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni vendosi që në tekstin e projektligjit duhet të vendosen numrat e neneve, konkretisht:

- Paragrafi i parë, për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese, të jetë Neni 1;
- Paragrafi i dytë për hyrjen në fuqi të jetë Neni 2.

Besnik BARAJ

Niko PELESHI

Relator

Kryetar